

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	633-23-3615-2-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj **Luard Mehmetaj B.I.**
NUI **811230870**
Adresa **Istog, Ibrahim Rugova**
Vendi **Istog**
Kodi postar **31000**
Numri Telefonit **+38343555657**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj **istogchannel@gmail.com**
Adresa elektronike
Data e parashtrimit të kërkesës **02.05.2023**

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontakt 14.04.2023

Data e hapjes së ofertave 08.05.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura të LPP-se:

Neni 1 – Qellimi

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi

Neni 28 – Specifikimi teknik

Neni 69 – Kapaciteti teknik dhe profesional

Neni 17.17 i Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me date **14.04.2023**, AK- Komuna Istogut e ka shpallur aktivitetin **LOT 1 - PUBLIKIMI I NJOFTIMEVE NE RADIO PER NEVOJAT E KOMUNES SE ISTOGUT, LOT 2 - PUBLIKIMI I LAJMEVE NE PORTAL DHE NEVOJAVE TJERA PER PUBLIKIM TE KOMUNES SE ISTOGUT-633-023-023-221**

Autoriteti Kontraktues Komuna Istogut ka shpallur aktivitetin e prokurimit me kriteret e dhenies:

Tenderi me çmim me te ulet , mirepo Autoriteti Kontraktues ka perdorur kriteret diskriminuese si te Pershkrimi i çmimit, poashtu edhe te formulari i dosjes se tenderit .

Autoritet kontraktues Komuna Istogu edhe ne kriteret e FDT pika 9.1& 9.2 Kapaciteti Teknik dhe profesional, ku te Kapacitetit teknik dhe profesional keni vendosur kete kriter:

**Kërkesa 2 -(vetem per loto 1)
Operatori ekonomik duhet te ofroje Deshmi qe ka frekuenca te regjistruara ne organin perkates-qe mbulon teritorin e komunes se Istogut.**

Dëshmia 3 Licenca valide per frekuenca te radios-kopje (qe mbulon teritorin e Komunes se Istogut).

Ku nga ky kriter shihet se keni bere shkelejen e nenit 7 te LPP-se sepse keni kerkuar:

Ju si AK ne kete kriter keni kerkuar qe Operatori Ekonomik te ofroj deshmi qe ka ferkuenca te regjistruar ne organini perkates - qe mbulon teritorin e komunes se Istogut . Deshmi - Licence valide per frekuenca e radios -kopje (qe mbulon teriotorin e Komunes se Istogut)

Ne kerkesen e lartshenuar ju na keni diskriminu neve si Operatori Eknomike qe kemi Televizon lokal me mbulushmeri edhe pertje teritorit te Istogut , dhe keni favorizur nje radio lokale me mbulushmeri shume me te vogel se ne .

AK me kete kerkese te cekura me larte ben shkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se, konkretisht nenit 7 (Barazia ne trajtim/jo diskriminimi), dhe qellimi i juaj si AK eshte per te favorizuar nje OE dhe diskriminuar shume te tjere me qellim qe te eliminon konkurrencen.

Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 7 te LPP-se (Barazia ne trajtim/jo diskriminimi) e sqaron shume qarte se OE duhet te trajtohen te barabarte:

1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo - diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Poashtu lidhur me mos-diskriminimin e OE-ve e paraqet qarte edhe neni 4 i RrUOPP-se 01/2022 per Prokurim Publik.

Paragrafi 3 i nenit 4 te RrUOPP-se e percakton shume qarte se Autoriteti Kontraktues te mos te perdor kritere diskriminuese, por te ju jep mundesi te barabarte te gjithe OE

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parën për Autoritetin Kontraktues.

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.

e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

Autoriteti Kontraktues të Përshkrimi i cmimit të dosjes së tenderit , të llojit 1 keni kërkuar

8	VIDEO INCIZIME ME DRONE PER AKTIVITETET E KRYETARIT	HERE	40
---	---	------	----

poz.8 Viedo incizime me drone per aktivitete e kryetarit , si ka mundesi keto video inqizime te shfaqen dhe te shihen ne radio ?

AK KK Istog perveq qe na ka diskriminuar ne momentin qe ka kerkuar Licence per Radio , duke kufizuar konkurrencen , edhe na anshkalur si Televizion lokal , dhe ne pershkrim te cmimeve ka kerkuar nje pozicion qe nuk ka logjike , per arsye se nuk ka ku te transmetohet .

Paragrafi 2 i nenit 28 te LPP-se e sqaron shume qarte se:

Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt

sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Kufizimi i konkurrencës ndikon që AK të demtojë buxhetin publik që bie ndesh me nenin 1 dhe 6 të LPP-së, andaj për tu ofruar mundësi të barabartë të gjithë OE-ve të ineteresuara sipas LPP-së dhe Rregullores për Prokurim Publik 01/2022 dhe kërkojmë nga ju si AK-Komuna e Istogu që të gjitha pozicionet që janë të pershkrjuara në parametere të harmonizuara me kontratat që janë funksionale.

Poashtu duhet të hiqni nga kriteri diskriminues siq është licenca e radios dhe atë me mbulueshmëri në teritorin e istogut sepse llogaritet si diskriminuese dhe favorizuese, ku shihet edhe të lista e cimeve që keni kërkuar në radio të transmetohen video inqizimet me drone.

Për këtë procedurë të prokurimit në po parashtojmë Kërkesë për rishqyrtim në mënyrë që AK KK Istog të reflektojë

duke larguar Kriterin Diskriminues dhe favorizues në duke bërë ndryshime të FDT në mënyrë që të mundësohet edhe në operatorëve tjerë pjesëmarrja

Andaj,

Kërkojmë edhe një herë nga ju si Autoritet Kontraktues që ta aprovoni kërkesën tonë, ndryshe nëse Kërkesa jonë nuk gjen aprovim atëherë jemi të obliguar që lenden ta dergojmë në OSHP si dhe institucione tjera relevante .

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

--

9. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.